

**VENDIM**  
**Nr. 156, datë 24.12.2015**

**MBI LËNIEN NË FUQI TË VENDIMEVE NR. 139, NR. 140, NR. 141,NR. 145,NR. 146,  
NR. 147, NR. 148, DATË 26.12.2014, SI DHE TË VENDIMIT NR. 27, DATË 16.2.2015, TË  
BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-s PËR PERIUDHËN 1 JANAR 2016 –  
30 QERSHOR 2016**

Në mbështetje të neneve 10, pika 2; 16; 20,germa “c”; dhe 109, pika 5, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, nenit 15, pika 1, dhe 3, të ligjit nr. 138/2013, “Për burimet e rinovueshme”, i ndryshuar, nenit 15 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar,Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 26.12.2015, pasi shqyrtoi relacionin e drejtorive teknike, si dhe rekomandimet e MEI-t për shtyrjen e afatit të tarifave dhe çmimeve të energjisë elektrike të miratuara për vitin 2015,

konstatoi se:

- Hartimi i akteve nënligjore dhe rregullatore përkatëse në përputhje me ligjin nr. 43/2015, nuk ka përfunduar.
- Mbyllja e detyrimeve të ndërsjella midis tre operatorëve është ende në proces rakordimi dhe ende nuk ka përfunduar.
- Tri kompanitë publike nuk kanë paraqitur planet e investimeve për vitin 2016.
- Tri kompanitë publike nuk kanë paraqitur aplikimet për rishikimin e tarifave për vitin 2016.
- Konstatohet një situatë e përmirësuar e sektorit, e cila shërben si indikator i mjaftushmërisë së tarifave të vitit 2015 për kryerjen e një aktiviteti normal nga tre operatorët.
- Ministria e Energjisë dhe Industrisë, si dhe tri kompanitë publike janë shprehur pro shtrirjes së efektit të tarifave dhe çmimeve aktuale të energjisë elektrike për 6-mujorin e parë të vitit 2016.
- Me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1033,datë 16.12.2015, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 221, datë 24.12.2015, është miratuar “Metodologjia e përcaktimit të tarifave fikse të energjisë që do t’i paguhen prodhuesve të energjisë elektrike nga hidrocentralet”. Në këtë VKM, i cili i shtrin efektet e tij për vitin 2016, në nenin 2 të tij është parashikuar dhe se ERE ngarkohet me detyrimin për të saktësuar se cili do të jetë çmimi i shitjes së energjisë së prodhuar nga prodhuesit e vegjël të energjisë për periudhën e ndërmjetme deri në daljen e një çmimi që do të aplikohet për vitin 2016.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

**VENDOSI:**

1. Të lërë në fuqi, deri në datën 30 qershor 2016, tarifat dhe çmimet e miratuara përkatësisht me vendimet si më poshtë:

- Vendimin nr. 139, datë 26.12.2014, “Për përcaktimin e tarifës së prodhimit të energjisë elektrike nga KESH sh.a. për vitin 2015”.
- Vendimin nr. 140, datë 26.12.2014, “Për përcaktimin e tarifës së energjisë elektrike për furnizuesin publik me shumicë për vitin 2015”.
- Vendimin nr. 141, datë 26.12.2014, “Për përcaktimin e tarifës për shërbimet ndihmëse të KESH sh.a. për vitin 2015”.
- Vendimin nr. 145, datë 26.12.2014, “Për përcaktimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike nga OST sh.a. për vitin 2015”.
- Vendimin nr. 146, datë 26.12.2014, “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike për vitin 2015 në nivelin e tensionit 35 kV”.
- Vendimin nr. 147, datë 26.12.2014,“Për përcaktimin e tarifës mesatare të shërbimit të

shpërndarjes së energjisë elektrike për vitin 2015”.

- Vendimin nr. 148, datë 26.12.2014, “Për përcaktimin e çmimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët taritorë për vitin 2015”.

2. Fuqia juridike e vendimit nr. 27, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, datë 16.2.2015, “Mbi miratimin e tarifës fikse të energjisë për vitin 2015, që do t’i paguhet prodhuesve të energjisë elektrike nga hidrocentralet, zgjatet deri në marrjen e vendimit të shfuqizimit të tij nga Bordi i ERE-s.

3. Pas publikimit të raportit vjetor (*Physical futures Annual report*) nga bursa e Hungarisë HUPX, për vitin përkatës, siç përcaktuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1033, datë 16.12.2015, ERE do të shprehet me vendim “Mbi miratimin e tarifës fikse të energjisë për vitin 2016, prodhuesve të energjisë elektrike nga hidrocentralet”.

4. Përditësimi dhe kompensimi i të gjitha efekteve të mundshme financiare për të licencuarit do të bëhet brenda vitit 2016.

5. Drejtorja e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë të interesuarit për vendimmarrjen e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
**Petrit Ahmeti**